



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 433/106 prot.

Elbasan, me 23.02.2024

VENDIM

Nr. 12, datë 23.02.2024

Për mbylljen e programit të studimit Master profesional në "Gazetari Sportive"

Në mbështetje të Ligjit 80/2015, datë 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 35, pika, neni 38, pika 1 gërma "dh" të Udhëzimit të MAS Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësave kryesore dhe programeve të studimit si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar Kreu IV, gërma C, pika b,c,d në shkresën me Nr. 36, datë 09.02.2024 të Fakultetit të Shkencave Humane, në Vendimin të Senatit Akademik nr. 21, datë 23.02.2024 "Për mbylljen e programit të studimit Master profesional në 'Gazetari Sportive'", Bordi i administrimit në mbledhjen e datës 23.02.2024,

V E N D O S I:

1. Të mbyllet në Fakultetin e Shkencave Humane programi i studimit Master profesional në "Gazetari Sportive".
2. Studentët e ngelur të këtij programi studimi ti krijohet mundësia e shlyerjes së provimeve ose ti transferojnë ato në një program të ngjashëm.
3. Ky vendim ti dergohet MAS për procedura të mëtejshme.
4. Ngarkohet Administratori i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Dr. Ardian DÛRMISHI

